



Universiteti "Aleksandër Moisiu"

Durrës

Nr. Prot. 1250 Durrës, 06.05. 2025



Instituti i Studimeve Për Krimet

dhe Pasojat e Komunjimit

Nr Prot. 178 Tirana, 19.05. 2025

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*ndërmjet:*

**UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS, SHQIPËRI**

*dhe*

**INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNJIMIT**

**Universiteti "Aleksandër Moisiu"** Durrës, Shqipëri (në vijim referuar UAMD), me adresë në: L. Nr.1, Rruga "Taulantia" Durrës, Shqipëri i përfaqësuar nga **Rektori, Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi** në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të institucionit dhe **Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunjimit**, (në vijim referuar si ISKK), me adresë në: Rruga e Saracëve, Tiranë, i përfaqësuar nga **Drejtori Ekzekutiv Z. Çelo Hoxha**, duke njohur përfitimet e institucioneve të tyre përkatëse nga krijimi i këtij bashkëpunimi, nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit akademik dhe në promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë midis dy institucioneve.

### **Neni 1**

#### **Dispozita të Përgjithshme**

Me vullnet të plotë palët synojnë të nxisin bashkëpunimin akademik dhe administrativ mbi bazën e barazisë dhe reciprocitetit të plotë.

### **Neni 2**

#### **Format e Bashkëpunimit**

UAMD dhe ISKK bien dakord të krijojnë një kornizë për bashkëpunimin si në vijim:

- a) Bashkëpunimi do të përfshijë shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e projekteve arsimore dhe kërkimore, me synimin për të kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive në fushat përkatëse.
- b) Pjesëmarrja dhe organizimi i seminareve, konferencave, evente dhe takime akademike;



- c) Shkëmbim të literaturës shkencore dhe informacioneve të tjera,
- d) Aktivitetete në ndërtimin e kapaciteteve;
- e) Krijimi i një rrjeti për shkëmbime të përvojës në tematika të ndryshme.

### **Neni 3**

#### **Financimi**

Të dy institucionet dakortësohen që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nuk ka implikime financiare nga cilado palë, megjithatë marrëveshjet specifike dhe eventuale financiare për aktivitete të veçanta do të përcaktohen paraprakisht, nëse ka raste të tilla.

Personeli Akademik/Administrativ pjesëmarres në shkëmbime/mobilitete duhet të veprojë me integritet, etikë dhe kompetencë duke respektuar legjislacionin e vendit pritës dhe rregulloret e universitetit pritës.

### **Neni 4**

#### **Të drejtat e autorit**

Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe dhe sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, çdo pronë e re intelektuale e krijuar si pasojë e kësaj Marrëveshjeje, normalisht do të jetë në pronësi të palës që e krijon atë, megjithëse për çdo ndryshim do të ketë hapsirë për të negociuar sipas rastit.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja, rinovimi, përfundimi dhe ndryshimet**

Çdo nen në këtë marrëveshje mund të ndryshohet ose rishikohet nga të dy institucionet me mirëkuptim nga palët. Çdo çështje që mund të lindë gjatë bashkëpunimit dhe që nuk përmendet në këtë marrëveshje, mund të zgjidhet me marrëveshje të ndërsjellë.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh nga data e nënshkrimit. Nëse njëra nga palët kërkon zgjidhjen e marrëveshjes, ajo mund të ndërpritet nga autoritetet përkatëse të secilës palë, duke i dhënë një njoftim dymbëdhjetë muajsh palës tjetër me shkrim, përveç rasteve kur një datë më e hershme e përfundimit është rënë dakord reciprokisht. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet ose zgjatet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të dy palëve.



## Neni 6

### Komunikimi

Të dyja palët bien dakord për të shkëmbyer rregullisht informacionin që e konsiderojnë të nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshje. Secili institucion pranon të caktojë një person kontakti i cili do të jetë përgjegjës për ofrimin dhe shpërndarjen e informacionit në institucionin që përfaqëson si dhe të jetë në kontakt të vazhdueshëm me homologun e tij/saj në Universitetin tjetër. Personat e kontaktit do të jenë përgjegjës për të punuar në zhvillimin e mëtejshëm të marrëveshjes.

- Për Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, person kontakti do të jetë Dr. Bledar Kurti, Drejtor, email: [bledarkurti@uamd.edu.al](mailto:bledarkurti@uamd.edu.al).
- Për ISKK kontakti do të jetë adresa e postes elektronike zyrtare: [info@iskk.gov.al](mailto:info@iskk.gov.al)

## Neni 7

### Hyrja në fuqi dhe afatet

Marrëveshja është hartuar në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlefshmëri ligjore, dy kopje për secilën palë. Marrëveshja bëhet e vlefshme menjëherë pas nënshkrimit nga titullarët përkatës.

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rinovimi të shkruar ose të heshtur.

Çdo nen mund të ndryshohet ose revokohet pas konsultimit dhe pëlqimit të ndërsjellë me shkrim ndërmjet Palëve.

## Neni 8

### Termet dhe Kushtet

Termet dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe statutet që rregullojnë të dy Universitetet. Palët nuk do të jenë të detyruara të respektojnë ato angazhime që rrjedhin nga marrëveshjet specifike, të cilat mund të bien ndesh me këtë parim.

Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, e cila nuk do të jetë e mundur të zgjidhet me mirëkuptim, do t'i referohet për zgjidhje një bord



arbitrazhi të përbërë nga një anëtar për secilën palë të marrëveshjes dhe një tjetër i zgjedhur me marrëveshje reciproke në rolin e Kryetarit.

Në dëshmi të kësaj dhe me vullnet të plotë, përfaqësuesit ligjor të institucioneve përkatëse, nënshkruajnë këtë Marrëveshje:

Për

**Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës**

**Rektori**

**Prof.Dr. Shkëlqim Fortuzi**



Për

**ISKK**

**Drejtori Ekzekutiv**

**Celo Hoxha**

